

Tirana Grand Prix WarmUp

Rregullore e Garës së Rregullsisë
Rrugë urbane e mbyllur (cirkuit rrethor i mbyllur) me disa xhiro

Organizatori: “Old Cars Club”, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Vendndodhja: Sheshi, Nënë Tereza

Data: 06.06.2026

Tirana Grand Prix WarmUp është një event (garë rregullsie) kombëtar, i cili bën pjesë në kalendarin e eventeve “RETRO” që organizohet çdo vit nga Old Cars Club, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Ky event (garë rregullsie) fton çdo të apasionuar të mjeteve historike të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe në rajon për t’u bërë pjesë e një sfide unike.

Ky event (garë rregullsie) ka disa qëllime parësore:

1. Kualifikimi: Shërben si etapë kualifikuese për ekuipazhet shqiptare dhe rajonale që do të marrin pjesë në finalen e madhe të “Tirana Grand Prix” në Tetor 2026.
2. Rritja e kapaciteteve: Synon rritjen e kapaciteteve menaxhuese të stafit “RETRO” në organizimin e eventeve të rëndësishme të këtij niveli.
3. Promovimi: Promovon motorizimin historik si një formë e veçantë e eksperiencës turistike dhe trashëgimisë kulturore.

Ekuipazhet dhe automjetet e tyre do të garojnë në një cirkuit (pistë) rrethor të mbyllur në Sheshin “Nënë Tereza”, duke e bërë këtë garë rregullsie një eksperiencë të paharrueshme për gjithsecilin prej tyre. Siguria mbetet përparësia jonë absolute, duke garantuar që ky event (garë rregullsie) të jetë një festë e vërtetë e historisë dhe e motorsportit.

Old Cars Club
IL PRESIDENTE
DOR. DURSIO ANTONIO

Përmbajtja

- Neni 1 Qëllimi dhe objekti
- Neni 2 Parimet e përgjithshme dhe përkufizime (terminologjia)
- Neni 3 Organizimi, autoritetet dhe bazat e zhvillimit
- Neni 4 Cirkuiti dhe formati i garës
- Neni 5 Pjesëmarrësit, kategoritë dhe kriteret e aplikimit
- Neni 6 Regjistrimi, dokumentacioni dhe verifikimi
- Neni 7 Kontrolli teknik
- Neni 8 Detyrimet dhe përgjegjësitë e pilotit
- Neni 9 Përjashtimi i përgjegjësive dhe deklarata e pjesëmarrjes me rrezik të pranuar
- Neni 10 Briefing (mbledhja zyrtare), programi i ditës dhe disiplina
- Neni 11 Matja e kohës dhe koha e synuar (target) e xhiros
- Neni 12 Procedura e startit, xhirot dhe rregullat
- Neni 13 Ndalimet, incidentet dhe rifillimet e garës
- Neni 14 Siguria dhe rregulla të detyrueshme
- Neni 15 Komunikimet zyrtare
- Neni 16 Rezultatet, klasifikimi dhe çmime
- Neni 17 Media, foto, video dhe të dhënat
- Neni 18 Tarifa e regjistrimit
- Neni 19 Numri maksimal i pjesëmarrësve
- Neni 20 Dispozita kalimtare
- Neni 21 Dispozita përfundimtare
- Aneksi 1 Harta e cirkuitit të garës
- Aneksi 2 Harta e Planit të Sigurisë

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat sportive, operative dhe kushtet e sigurisë për zhvillimin e “Tirana Grand Prix WarmUp” si event (garë rregullsie) kualifikues për finalen e “Tirana Grand Prix”, që do të organizohet në Tetor 2026, në një cirkuit (pistë) rrethor të mbyllur me disa xhiro.

Neni 2

Parimet e përgjithshme dhe përkufizime (terminologjia)

1. Siguria ka përparësi absolute ndaj garës dhe rezultatit.
2. Fiton ekuipazhi me devijimin total më të vogël nga koha e synuar (target) e xhiros.

Për qëllime të kësaj Rregulloreje, përkufizimet e mëposhtme kanë kuptimin si vijon:

- I) Cirkuiti (pista) – Segment rrugor urban i mbyllur plotësisht për qarkullimin publik, i pajisur me gardhe rrethuese (*guardrails*) dhe i destinuar ekskluzivisht për zhvillimin e xhirove të garës.
- II) Xhiro – Një qarkullim i plotë i automjetit në cirkuit nga pika “Start/Finish” deri në rikthimin në të njëjtën pikë.
- III) Koha e synuar (target) – Koha standarde e shpallur nga Organizatori që çdo ekuipazh duhet të synojë të realizojë në një xhiro.
- IV) Devijimi – Diferenca në sekonda midis kohës reale të regjistruar dhe kohës së synuar (target).
- V) Penaliteti – Shuma e sekondave të devijimit të grumbulluara gjatë xhirove, që përcakton renditjen përfundimtare; penalitetet më i ulët përkthehet në rezultat më të mirë.
- VI) Start/Finish – Pika e vetme zyrtare në cirkuit ku regjistrohet koha e çdo xhiroje.
- VII) Briefing – Mbledhja zyrtare informuese e organizuar para garës ku jepen udhëzimet operative dhe të sigurisë; pjesëmarrja është e detyrueshme.
- VIII) Parc Fermé (Parkim i Mbyllur) – Zonë e kontrolluar dhe e mbikëqyrur nga Organizatori ku automjetet qëndrojnë para dhe/ose pas garës, pa ndërhyrje teknike të paautorizuar.
- IX) Neutralizim – Procedurë e përkohshme e ndërprerjes ose ngadalësimit të garës për arsye sigurie, sipas urdhrat të Drejtuesit të Garës.
- X) Komisarët (*Marshals*) – Personel i autorizuar përgjegjës për monitorimin e cirkuitit, sinjalizimin dhe raportimin e çdo incidenti.
- XI) Sekretariati i Garës – Struktura administrative që menaxhon dokumentacionin, njoftimet dhe publikimin e rezultateve zyrtare.

- XII) Ekuipazh – Përbërja e automjetit pjesëmarrës, nga piloti dhe bashkëpiloti.
- XIII) Pit-stop / Zona operative – Zonë e përcaktuar për ndalim teknik ose organizativ me regjim të kufizuar shpejtësie.

Neni 3

Organizimi, autoritetet dhe bazat e zhvillimit

1. Organizatorët janë Old Cars Club, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, të cilët në vijim të kësaj Rregulloreje do të njihen shkurtimisht si Organizatori.
2. Organizatori është përgjegjës për zhvillimin e eventit (garës), përfshirë planin e sigurisë dhe emergjencës, si dhe koordinimin me shërbimet përkatëse.
3. Organizatori është përgjegjës për marrjen e lejeve për mbylljen e territorit, rrugët dhe masat e rendit publik, sipas kërkesave të Bashkisë përgjegjëse dhe Policisë së Shtetit (Policia Rrugore dhe e Rendit), si dhe strukturave të emergjencës (Ambulancë, Zjarrfikëse).
4. Në funksion të organizimit të eventit (garës), Organizatori e ushtron funksionin e tij nëpërmjet:

4.1. Drejtuesit të Garës, i cili është autoriteti më i lartë ekzekutiv i garës dhe i mbarëvajtjes sportive të saj. Pjesë e kompetencave është e drejta për të marrë vendime të menjëhershme për: “START/STOP/NEUTRALIZIM/ANULIM”, në koordinim me Drejtuesin e Logjistikës, Sigurisë dhe Perimetrit të Cirkuitit;

4.2 Drejtuesit të Logjistikës, Sigurisë dhe Perimetrit të Cirkuitit, i cili është autoriteti kryesor për sigurinë fizike të eventit (garës) dhe logjistikën operative (perimetri, publiku, pikat e hyrjes, barriera, fluksi). Jep: “GJITHÇKA NË RREGULL” për hapjen/vazhdimin e segmentit vetëm kur kushtet janë të sigurta. Ka të drejtë të kërkojë: “STOP/NEUTRALIZIM” te Drejtuesi i Garës kur identifikon rrezik real.

4.3. Sekretariatit të Garës, i cili regjistron, dokumenton, publikon njoftimet dhe rezultatet. Punon ngushtë me Drejtuesin e Garës dhe Matësit e Kohës.

4.4. Kryekomisarit (Krye-marshal), i cili është autoriteti kryesor disiplinor/juridik-sportiv në garë. Ai, së bashku me komisarët e garës, garanton që rregullorja të zbatohet në mënyrë të drejtë, të dokumentuar dhe si një proces i rregullt. Ai nuk menaxhon rrjedhën operative të xhirove (këtë e bën Drejtuesi i Garës), por mbikëqyr korrektësinë e vendimmarrjes sportive dhe trajton çështjet disiplinore.

Neni 4
Cirkuiti dhe formati i garës

1. Cirkuiti është rrethor, i mbyllur plotësisht dhe i rrethuar me gardhe rrethuese (*guardrails*).
2. Hyrja në cirkuit (pistë) lejohet vetëm për pilotët, bashkëpilotët dhe stafin e autorizuar.
3. Përpara nisjes, Organizatori njofton kohën e synuar (target) që çdo ekuipazh duhet të respektojë me përpikmëri gjatë xhirove.
4. Çdo automjet kryen xhiro të kronometruara nga kohëmatësit e autorizuar, ku koha e çdo xhiroje regjistrohet në pikën “Start/Finish”.
5. Numri i xhirove të kronometruara, intervali i nisjes dhe programi ditor shpallen në njoftimin e Garës (Buletin) dhe në *briefing* (mbledhjen zyrtare informuese).

Neni 5
Pjesëmarrësit, kategoritë dhe kriteret e aplikimit

1. Aplikimi është i hapur për automjetet historike të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe në vende të tjera të rajonit. Për automjetet e regjistruara në Republikën e Shqipërisë, kërkohet që ato të jenë të pajisura me statusin e automjetit historik “RETRO”. Për automjetet e regjistruara në vende të tjera të rajonit, kërkohet që pronari të jetë anëtar i një shoqate ose klubi të njohur për ruajtjen e automjeteve historike dhe që automjeti të jetë i pajisur me dokumentacion të rregullt e të vlefshëm sipas legjislacionit përkatës. Të gjitha automjetet duhet të jenë në gjendje teknike të përshtatshme për pjesëmarrje, në përputhje me nenin 7 të kësaj Rregulloreje.
2. Nëngrupet e pjesëmarrjes sipas vitit të prodhimit:
 - RETRO Classic: deri në vitin 1970
 - RETRO Modern Classic: nga 1971 deri në 1995
3. Ekuipazhi përbëhet nga piloti dhe bashkëpiloti.

Neni 6
Regjistrimi, dokumentacioni dhe verifikimi

1. Aplikimi kryhet përmes platformave online www.retro.al dhe www.dpshttr.gov.al. Pjesëmarrja konsiderohet e konfirmuar vetëm pas miratimit zyrtar nga Organizatori.
2. Dokumentet e nevojshme:
 - Certifikatë njohjeje si automjet RETRO, ose certifikatë regjistrimi e vendit nga vjen automjeti;
 - Automjeti duhet të jetë i siguar sipas parashikimeve ligjore në Republikën e Shqipërisë, ndërsa automjetet që vijnë nga jashtë vendit duhet të jenë të

siguruara sipas dispozitave ndërkombëtare për sigurimin e automjetit; Leje drejtimi e kategorisë B, e vlefshme; Deklaratë përgjegjësie (firmosur).

3. Pjesëmarrja kushtëzohet nga gjendja teknike e automjetit. Organizatori ka të drejtën e refuzimit nëse automjeti nuk plotëson kriteret e sigurisë.

Neni 7

Kontrolli teknik

1. Në datën 6 Qershor, para zhvillimit të garës secili automjet i pranuar do të kryej kontrollin teknik pranë Qendrës së Kontrollit Teknik, “Tirana 2”.
2. Kontrolli do të kryhet nga inspektorët e certifikuar të QKT.
3. Sistemet që kontrollohen:
 - Goma në gjendje të mirë dhe presion i arsyeshëm;
 - Sistem drejtimi;
 - Sistemi i frenimit;
 - Rripat e sigurimit;
 - Pa rrjedhje lëngjesh në mënyrë të theksuar;
 - Bateria e fiksuar mirë.

Automjeti duhet të jetë estetikisht i pranueshëm edhe pa defekte të dukshme që rrezikojnë sigurinë.

Nëse automjeti rezulton me defekte nga sistemet e mësipërme, nuk mund të regjistrohet për pjesëmarrje në garë.

Neni 8

Detyrimet edhe përgjegjësitë e pilotit

1. Gara e rregullsisë nuk është garë shpejtësie; sjellja agresive ndalohet rreptësisht.
2. Ndalohet parakalimi i çdo automjeti tjetër në cirkuit (pistë), pavarësisht diferencës së shpejtësisë apo ritmit të xhiros. Piloti duhet të ruajë pozicionin dhe të mbajë distancë të sigurt, pa manovra “presioni” apo “shtyrje” për parakalim.
3. Në rast defekti teknik ose problemi tjetër që detyron ndalimin e garës, piloti duhet të ndalojë automjetin jashtë trajektores në mënyrë të sigurt, të zbatojë udhëzimet e komisarëve dhe të mos rikthejë automjetin në cirkuit (pistë) pa autorizimin e drejtuesit të garës.
4. Ndalohet ndalimi i plotë i automjetit dhe/ose frenimi i fortë që sjell ndalim, përfshirë “STOP” të qëllimshëm për të korrigjuar kohën e xhiros. Lejohet vetëm frenim i moderuar, linear dhe i parashikueshëm, pa krijuar rrezik për automjetet pas.
5. Çdo mosrespektim i sinjaleve të komisarëve (*marshals*) ose krijimi i rrezikut për publikun ose stafin drejtues, sjell përjashtim.
6. Piloti është i detyruar të respektojë këtë Rregullore, udhëzimet e stafit, sinjalizimet dhe komunikimet operative para, gjatë dhe pas garës.

7. Pjesëmarrja bëhet me përgjegjësi personale. Çdo pilot konfirmon se automjeti është në gjendje të përshtatshme dhe se i kupton rreziqet e një aktiviteti motor sportiv.
8. Rripat e sigurimit duhet të jenë të vendosur gjatë gjithë kohës së zhvillimit të garës.
9. Çdo automjet duhet të ketë sigurim të vlefshëm sipas kërkesave të njoftimit të garës.
10. Organizatori pajis çdo ekuipazh me 1 numër, i cili duhet të vendoset përpara garës në të dy anët e automjetit, në mënyrë të dukshme, pa u prerë ose modifikuar dhe duke ruajtur elementët e identifikimit dhe/ose reklamimit të përcaktuar nga Organizatori. Automjetet pa numra nisjeje të vendosur në mënyrë korrekte nuk do të lejohen të marrin pjesë në garë.
11. Vendosja dhe mirëmbajtja e numrave gjatë gjithë garës është përgjegjësi e pilotit, sipas udhëzimeve të Organizatorit.
12. Përjashtime:
 - 12.1. Parakalimi ose ndalimi lejohet vetëm në raste të domosdoshme sigurie, si:
 - Incident/defekt teknik, rrezik i menjëhershëm, pengesë në circuit (pistë);
 - Sinjalizim ose urdhër i komisarëve/ drejtuesit të garës (p.sh. flamur i Verdhë, i Kuq, STOP);
 - Hyrje/dalje e detyruar nga zona e sigurisë ose asistencës.
13. Piloti është i detyruar të parandalojë aksidente të qëllimshme.

Neni 9

Përjashtimi i përgjegjesisë dhe deklarata e pjesëmarrjes me rrezik të pranuar

Organizatori, stafi, bashkëpunëtorët dhe partnerët e garës nuk mbajnë asnjë përgjegjësi civile apo penale për çdo dëm material, mekanik apo fizik që mund të ndodhë para, gjatë ose pas zhvillimit të garës. Ky përjashtim përgjegjësie përfshin, pa u kufizuar në, dëmtimet e automjeteve, pajisjeve, pronës personale, si dhe çdo lëndim fizik të pilotëve, anëtarëve të ekuipazhit, spektatorëve apo palëve të treta.

Me regjistrimin dhe pjesëmarrjen në garë, çdo pilot deklaron se merr pjesë me vullnetin e tij të lirë, me përgjegjësi të plotë personale dhe në dijeni të plotë të rreziqeve që lidhen me natyrën e aktivitetit. Piloti heq dorë në mënyrë të përvokueshme nga çdo pretendim, kërkesë dëmshpërblimi apo veprim ligjor ndaj Organizatorit, stafit, bashkëpunëtorëve dhe partnerëve të garës për çdo dëm që mund të rrjedhë nga pjesëmarrja në garë.

Piloti garanton gjithashtu se automjeti është në gjendje të përshtatshme teknike dhe se disponon dokumentacionin e nevojshëm dhe mbulimin e sigurimit të detyrueshëm sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 10

Briefing (mbledhja zyrtare informuese), programi i ditës dhe disiplina

1. *Briefing* (mbledhja zyrtare informuese) është e detyrueshme dhe zhvillohet nga Drejtuesi i garës përpara fillimit të garës, në praninë e të gjithë ekuipazheve.
2. Mos marrja pjesë në *briefing* sjell përjashtim nga gara.

Neni 11

Matja e kohës dhe koha e synuar (target) e xhiros

1. Matja e kohës kryhet me sistem kohëmatjeje (fotoqelizë/gate/transponder), sipas marrëveshjes me kohëmatësit e autorizuar nga Organizatori.
2. Organizatori shpall një kohë të arritshme për secilën kategori.
3. Koha e synuar(target) përcaktohet dhe shpallet përpara fillimit të garës.
4. Vlerësimi dhe mënyra e matjes së kohës (*shembull*):
 - 4.1. Shembull për 5 xhiro
Sekondat “shtesë” janë koha që i shtohet rezultatit final të ekuipazhit si pasojë e devijimit nga koha e synuar (target) për çdo xhiro.


Në këtë shembull, koha e synuar (target) është (1:40.00). Për çdo xhiro që piloti arrin më herët ose më vonë në Finish, sekondat e devijuara nga koha e synuar (target), numërohen si penalitet:

Xhiro	Koha reale	Diferenca	Lloji	Penaliteti (sek)
1	1:39.20	-0.80s	Herët	0.80 = 0.80
2	1:40.50	+0.50s	Vonë	0.50 = 0.50
3	1:41.10	+1.10s	Vonë	1.10 = 1.10
4	1:39.70	-0.30s	Herët	0.30 = 0.3
5	1:40.00	0.00s	Saktë	0.00

Total = 0.80 + 0.50 + 1.10 + 0.30 + 0.00 = 2.70 sekonda

Në këtë shembull, shumatorja e devijimeve/penalitetëve është 2.70 sekonda.

Kjo do të thotë: piloti ka humbur gjithsej 2.70 sekonda nga koha e synuar (target) dhe në renditje, rezultati i tij llogaritet me +2.70 sekonda penalitet në total (krahasuar me një pilot që do t'i kishte të gjitha xhirot 0.00 sek diferencë).

Old Cars Club
IL PRESIDENTE
Dott. DIURSO ANTONIO


Neni 12


Procedura e startit, xhirot dhe rregullat.

1. Nisja kryhet një e nga një me interval të përcaktuar nga Organizatori për të shmangur “garimin” ndërmjet pilotëve. Çdo veprim që ka për synim “garimin” ndërmjet piloteve sjell përjashtim.
2. Drejtimi i qarkullimit është i detyrueshëm vetëm në një krah rrotullimi; çdo kundërvajtje sjell përjashtim.
3. Koha e matur e një xhiroje në pistë është vetëm ajo e regjistruar nga kronometri i autorizuar nga Organizatori.

Neni 13

Ndalimet, incidentet dhe rifillimet e garës

1. Në rast incidenti në garë, siguria ka përparësi mbi të gjitha.
 - 1.1. Protokoli bazë në raste incidenti:
 - Raportim i menjëhershëm nga komisarët: “vendndodhja; natyra e incidentit; a ka të lënduar”;
 - Drejtuesi i Garës urdhëron “NGADALËSIM” dhe sipas rastit, “NDALIM GARE”;
 - Drejtuesi i Logjistikës, Sigurisë dhe Perimetrit të Circuitit izolon zonën dhe garanton korridorin e emergjencës.
 - Ndërhyrja mjekësore ose zjarrfikësi kryhet sipas nevojës.
 - Rifillimi i garës bëhet vetëm pas konfirmimit “GJITHÇKA NË RREGULL” nga Përgjegjësi i Sigurisë dhe urdhrit “RIFILLIM” nga Drejtuesi i Garës.
 - Hyrja hapet vetëm për emergjencë dhe vetëm pas dhënies së sinjalit “STOP START”, sipas urdhrave të Drejtuesit të Garës.
2. Përgjatë gjithë kohës së zhvillimit të garës dhe deri në momentin kur të gjithë pjesëmarrësit kanë përfunduar xhiron dhe janë kthyer në zonat operative (pit-stop), automjetet e sigurisë, ambulanca, komisarët (*marshals*) dhe automjetet/linjat e komunikimit operativ qëndrojnë në pozicion. Vetëm pas përfundimit të plotë të garës, Drejtuesi i Garës jep urdhrin që strukturat e sigurisë të lirohen nga detyra.

Old Cars Club
IL PRESIDENTE
Dott. DI PASO ANTONIO


Neni 14
Siguria dhe rregulla të detyrueshme

1. Publiku nuk lejohet të qëndrojë pranë gardheve rrethuese (guardrails). Zonat e ndaluara dhe të lejuara përcaktohen nga Drejtuesi i Logjistikës, Sigurisë dhe Perimetrit të Cirkuitit.
 2. Pjesëmarrësit duhet të respektojnë:
 - 2.1. Urdhrat e komisarëve dhe sinjalistika:
 - STOP/ Flamuri i Kuq;
 - KUJDES/ Flamuri i Verdhë;
 - VAZHDO/ Flamuri i Gjelbër;
- * *Shpejtësi të limituar prej 5 km/h në zonat operative (pit-stop).*
3. Alkooli dhe substancat që ulin aftësinë drejtuese ndalohen rreptësishtë.

Neni 15
Komunikimet zyrtar

1. Rezultatet shpallen duke respektuar afatin e përcaktuar nga Drejtuesi i Garës.
2. Rezultati paraqitet në Sekretariatit e Garës dhe u komunikohet ekuipazheve.

Neni 16
Rezultatet, klasifikimi dhe çmimet

1. Klasifikimi përfundimtar bazohet në penalitetin total më të ulët të grumbulluar sipas shembullit të dhënë më sipër në Nenin 11, pika 4.1.
2. Organizatori publikon listën e fituesve dhe rezultatet finale.
3. Çmimet sipas rezultatit përcaktohen nga organizatori:
 - Vend i parë / dytë / tretë sipas kategorive përkatëse.

Neni 17
Media, foto, video dhe të dhënat

1. Pjesëmarrësi pranon që Organizatori mund të përdorë foto/video të eventit për qëllime informimi dhe promovimi.
2. Media, Foto-Video duhet të akreditohet nga Organizatori për të hyrë në zonat e caktuara.
3. Media, Foto-Video duhet të respektojë zonat e lejuara dhe udhëzimet e Drejtuesit i Logjistikës, Sigurisë dhe Perimetrit të Cirkuitit; shkeljet sjellin heqjen e autorizimit.

Neni 18
Tarifa e regjistrimit

Pjesëmarrja dhe regjistrimi në garë kushtëzohen nga pagesa nga pagesa e një tarife prej 50 € për çdo mjet të miratuar nga “Old Cars Club”, e cila shërben për mbulimin e kostove të organizimit të eventit dhe shërbimeve të vëna në dispozicion të pjesëmarrësve gjatë zhvillimit të aktivitetit.

Neni 19
Numri maksimal i pjesëmarrësve

Numri maksimal i mjeteve të lejuara për pjesëmarrje në garë është 50. Organizatori rezervon të drejtën për të mbyllur regjistrimet me arritjen e këtij limiti, si dhe për të përzgjedhur aplikimet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga “Old Cars Club”.

Neni 20
Dispozita kalimtare

Kjo rregullore është e zbatueshme vetëm për eventin (garën) e “Tirana Grand Prix WarmUp”

Neni 21
Dispozita përfundimtare

1. Organizatori mund të nxjerrë njoftime sqaruese, për ndryshime përpara ose gjatë eventit (garës), nëse kërkohet për qartësi ose siguri.
2. Në çdo konflikt interpretimi, vendimi i Drejtuesit të Garës është përfundimtar për aspektet sportive, ndërsa vendimi i Drejtuesit të Logjistikës, Sigurisë dhe Perimetrit të Circuitit është përfundimtar për aspektet e sigurisë.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi në momentin e publikimit nga Organizatorët.


Old Cars Club
IL PRESIDENTE
Dott. DARSO ANTONIO


Aneksi 1

Harta e Planit të Sigurisë

(harta e cirkuitit të garës me shërbimet, gardhet rrethuese dhe masat e sigurisë)

Planimetria e Pistes se TGP Shkalla 1:1000



- Legjenda**
- Pista 1070 m
 - Traseja h=1m
 - - - Barriera
 - ⊠ Stendë ekspozimi
 - Start & Finish
 - Hyrje
 - Dalje
 - Pozicionim Shikuesish
 - Ambulanca
 - Zjarrfikësja
 - Karrotrec
 - Sipërfaqe e zene me trasena 16 250 m²

Punoi:
Ark. Dorian Sinani

Aneksi 2
Harta e circuitit të garës (pika e nisjes dhe e përfundimit)

